



Shkodër, 25.04.2019

Thirrje për Regjizor dokumentari

Pozicioni: Regjizor dokumentari

Titulli i projektit: “Youth WAVE for Human Rights”

Shtyrja e afatit të aplikimit: 15 Maj 2019

1. Përshkrim i përgjithshëm i projektit

Projekti “Youth Wave for Human Rights” zbatohet në Shkodër, në kuadër të Projektit “Të rinjtë në Shqipëri për të Drejtat e Njeriut”, i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga World Vision në bashkëpunim me Rrjetin e të Rinjve Jugoro-Lindor. Ky projekt ka për qëllim aftësimin dhe fuqizimin e të rinjve për të ndërtuar komunitete miqësore dhe respektuese ndaj të drejtave të njeriut dhe përfshin zhvillimin e një sërë aktivitetesh që i shërbejnë arritjes së këtij qëllimi.

2. Qëllimi i kontratës

Përcaktimi i termave të angazhimit të regjizorit të dokumentarit në përgatitjen e dokumentarit për të drejtat e njeriut.

3. Produkti i punës

Dokumentar për të drejtat e njeriut, me qëllim rritjen e ndjeshmërisë dhe ndërgjegjësimin të komunitetit të Shkodrës për çështje që lidhen me të drejtat e njeriut. Ky dokumentar do të pasqyrojë punën e bërë në zbatim të këtij projekti dhe në të njëjten kohë do të adresojë çështjet që lidhen me të drejtat e njeriut sipas planit ndërhyres të projektit.

4. Vendi i zhvillimit të aktivitetit

Aktiviteti do të zhvillohet në hapsirën territoriale të Bashkisë Shkodër dhe Pukë, konkretisht Njësia Administrative Rrethina, Ana e Malit, Rajoni nr. 5 dhe Gomsiqe.

5. Roli dhe përgjegjësitë e regjizorit

Aktiviteti i parë i parashikuar ka të bëjë me nënshkrimin e kontratës që konsiston në:

- konceptimin, editimin, të folurit/narratorin, duke konkluduar me produktin final të gatshëm për transmetim. I gjithë procesi i realizimit të këtij dokumentari do të monitorohet nga stafi koordinues i projektit dhe shoqata “Gruaja tek Gruaja”, të cilët në të njëjten kohë do të jenë edhe mbështetës duke ofruar sugjerime, komente dhe inpute varësisht nga nevoja;
- Koordinon filmimin dhe intervistat;
- “Gruaja tek Gruaja” dhe stafi i angazhuar në projekt do miratojnë bashkarisht produktin final.



Pas nënshkrimit të kontratës, regjizori në bashkëpunim me Koordinatorin e Projektit duhet të sigurohet që organizimi i këtij aktiviteti të vecantë të zhvillohet në përputhje të plotë me objektivat e projektit.

6. Kohëzgjatja e kontratës dhe planifikimi i punës

1. Aktiviteti nis menjëherë pas nënshkrimit të kontratës.
2. Brenda 20 ditësh nga fillimi i marrëdhënies së punës duhet të dorëzohet një plan i detajuar pune i mirëpërcaktuar në kohë.
3. Një buxhet i detajuar duhet të dorëzohet para se të fillojnë procedurat e filmimit.
4. Produkti final duhet të jetë i përfunduar deri me datën 31 Dhjetor 2019.

7. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati

- Eksperiencë në shkrim, prodhim, editim dokumentarësh/filmash/reportazhesh.
- Aftësi për të punuar brenda limiteve kohore të përcaktuara dhe me standarte të larta profesionalizmi.
- Fleksibilitet me oraret dhe udhëtimet sipas aktiviteteve të parashikuara në projekt.

8. Dokumentacioni i nevojshëm

- CV;
- Letër motivimi;
- Portofolio (video, dokumentar, film i shkurtër, reportazh) i cili demonstroi eksperiencën në këtë fushë.
- Kopje ID.

9. Pagesa

Mënyra e pagesës do të kryhet varësisht nga vullneti i të kontraktuarit në përfundim të të gjitha detyrimeve të listuara apo me disa transhe duke i lidhur ato me detyra të përfunduara.

10. Aplikimi

Aplikimi duhet të dërgohet brenda datës 15.05.2019 me e-mail në adresën: gruajatekgruaja@gmail.com.